

## PROCESI I KOMUNIKIMIT TE FËMIJËT NGA MOSHA 0-5 VJEÇ, METODA DHE PRAKTIKA PËRMES INSTRUMENTEVE KONKRETE

### Si nis komunikimi?

Që në momentet e para kur çifti merr vesh lajmin se do të bëhen prindër, ata thurin ëndrra dhe dëshira për fëmijën e tyre. Idetë e tyre imagjinare janë nga më të largëtat, më të veçantat dhe mjaft interesante. Në librin “Kur qau Niçja”, psikanalisti Irvin Yalom, ndër shumë mesazhe, jep atë më kryesorin, se të jesh prind nuk do të thotë të riprodhosh veten, por të ndërtosh një qenie më të mirë sesa veten. Prindërimi, kohët e fundit, shoqërohet me sfida të vështira dhe shumëdimensionale, të cilat janë gjithashtu edhe të papritura. Megjithatë, në mënyrë të përgjithshme, prindi duhet të kuptojë shumë qartë, se detyrat dhe përgjegjësitë e tij për fëmijën do të jenë të panumërta dhe themelore, sidomos në vitet e para të jetës së tij. Duhet theksuar se komunikimi është thelbi i edukimit. Përmes fjalëve që do të përdorë, gjesteve të fytyrës apo të trupit, zërit, intonacionit etj., prindi edukon. Fëmija zhvillohet me stade dhe çdo veprim ose joveprim i nënës apo babait ngre blloqe në formimin e tij. Ata mund të nisin shumë mirë dhe më pas të rrëzojnë ndonjë prej këtyre blloqeve, ndaj duhet pasur kujdes në çdo hap. Në tërësi, gjatë edukimit, pothuajse për çdo gjë, prindi duhet të negociojë. Ata do t'i prezantojnë fëmijës lidhjen me botën, marrëdhënien me veten, si të menaxhojnë stresin, humorin e keq dhe inatin. Ky komunikim faktikisht nuk nis me lindjen e fëmijës, apo kur fëmija është gati të artikulojë fjalët e para. Madje atëherë mund të jetë edhe disi vonë. Komunikimi midis prindërve dhe fëmijës nis që në barkun e nënës. Në këtë fazë është lidhja kryesore që formësohet midis qenies së re, e cila po krijohet dhe gruas e cila do të bëhet nënë. Trupi i saj, i cili nis të ndryshojë, i komunikon asaj se jeta nuk do të jetë më si më parë, duke nisur që me ushqyerjen, përkujdesjen fizike, perceptimet mbi veten dhe mëmësinë. Nëna e re i mëson këto pak e nga pak, me kalimin e kohës.

Ka një rëndësi të madhe komunikimi që nëna krijon me të voglin që ka brenda trupit të saj. Kjo ndihmon edhe gjendjen psikologjike të saj, pasi lehtëson ngarkesën emocionale. Ky atashim është i rëndësishëm, sepse ai ndikon thellësisht në çdo aspekt të jetës së fëmijës, ai ndikon në mendjen, trupin, emocionet, marrëdhëniet, vlerat. Atashimi është përkufizuar si një sistem rregullator i ndërsjelltë. Fëmija dhe prindi ndikojnë te njëri-tjetri, me kalimin e kohës.<sup>1</sup>

## Komunikimi formon konceptin për veten

Shpesh, fëmija në fytyrën e tij reflekton vështrimin e atij që po e sheh ose riprodhon në trupin e tij, gjestet e trupit që ai sheh.<sup>2</sup> Kjo do të thotë që ai është një kopjues i mirëfilltë, së pari i prindërve të tij, e më tej i aktorëve të tjerë që do marrin pjesë në edukimin e tij. Ndaj kujdesi që duhet të kenë prindërit në komunikimin e fëmijëve, por edhe me njëri-tjetrin, duhet të jetë i menduar mirë.

Hapi i parë në formimin dhe në zhvillimin e vetë konceptit është aftësia për të njohur veten si një entitet i veçantë. Në këtë kuptim, vetë koncepti është shuma e besimeve që kemi për vlerat e vetes.<sup>3</sup> Më këtë duhet të kuptojmë metodat që përdor prindi për të stimuluar, për të nxitur apo për të frenuar fëmijën e tij me anë të komunikimit, do të reflektohen në vetëvlerësimin e tij. Një prind i cili në pjesën më të madhe të kohës ushtron dhunë psikologjike, duke përdorur një nivel të lartë të zërit e më pas i shoqëron me fjalët “Ti nuk mundesh, ti nuk e bën dot”, frenon mundësitë e fëmijës për të përparuar, qoftë edhe për të vepruar, edhe në rast se mund të dështojë.

Hapi i dytë lidhet me shoqërizimin dhe aktorët që marrin pjesë në edukim. Shoqëria, edukatorja, mësuesi etj., do të jenë pjesa tjetër, të cilët do të edukojnë fëmijët përmes komunikimit. Madje eksperiencat që përjetojnë fëmijët gjatë fëmijërisë së hershme janë vendimtare, sepse ai krijon paraide dhe ide, mendime dhe më pas i artikulon ato. Prindërit nuk u mësojmë vetëm fjalë fëmijëve e më pas fjali, por ua ndërtojnë botën përmes komunikimit. Nëse prindërit kanë kohë që e kanë humbur interesin për të mësuar më shumë rreth ngjarjeve dhe ndodhjeve, fëmija është në kulmin e përthithjes dhe dëshirës për të ditur më tepër. Vitet e para të jetës së fëmijës

1 Marsela Tarelli, “Fëmijët investim i së ardhmes”, Alsar, 2014.

2 Jean Pierre Meunier Daniel Peraya, *Hyrje në teoritë e komunikimit*, QSSHE, Botimi i dytë, Tiranë 2009, f. 157

3 Edmond Dragoti, *Psikologjia sociale*, Toena, 2004, f. 37.

kërkojnë një përkushtim maksimal, i cili nuk kthehet më mbrapsht, nuk të lë të presësh, sepse çdo ditë është mundësi për më shumë njohuri.

Prej vitesh po shkruhen dhe po bëhen shumë të shitur libra të cilët iu tregojnë lexuesve mënyra të ndryshme për të arritur majat e biznesit apo të arritjeve profesionale dhe kjo e lidhur ngushtë me komunikimin. Në librin e tij “Marrëdhëniet njerëzore”, autori Mel E. Schanake, thekson rëndësinë e tipave të ndryshëm të personaliteteve në ecurinë e një kompanie. Ndër të tjera, ai vlerëson personalitetin e tipit T, i cili ka nevoja të mëdha për ndryshime dhe adrenalinë, i cili madje edhe thyhen rregullat e zakonshme për të arritur më të mirën në profesion.<sup>4</sup> Por e gjitha kjo realizohet vetëm përmes komunikimit efektiv, deri në metodat tërheqëse të komunikimit që përdor ky individ për ta përçarur tek të tjerët.

## Të zbërthejmë komunikimin

Në moshën 1-vjeçare te fëmijët fillojnë të zhvillohen aftësitë metalinguistike, të cilat lidhen me aftësinë për të menduar dhe përdorur gjuhën. Diku pas moshës 2-vjeçare, të vegjlit mund të imitojnë ose përdorin zëra të ndryshëm sipas kërkesave që kanë. Ndërsa pas moshës 4-vjeçare, kanë mundësi të identifikojnë dhe të përdorin gjuhën trupore. Në vijim të viteve këto aftësi vijnë duke u përmirësuar.<sup>5</sup> Fëmija nis një diskutim duke shprehur një mendim, por nuk duhet të harrojmë që ky mendim nuk ka ardhur nga hiçi. Ai është formuar nga mësimet e marra nga prindërit, shkolla, librat, apo mënyra të tjera të edukimit informal. Ndryshe nga të rriturit, të vegjlit nuk janë të pajisur me filtra për të nisur komunikimin dhe nuk e mendojnë gjatë, nëse duhet apo jo të komunikojnë, apo a është momenti i duhur për këtë komunikim. Ata nxiten nga kurioziteti dhe dëshira për të mësuar më shumë rreth botës që i rrethon. Nëse zbërthejmë mendimin e një të rrituri, para se ai të nisë komunikimin, do të shkojmë më tutje duke kuptuar që para mendimit ka qenë dëshira, vullneti, ose ndonjë rrethanë nxitëse për të nisur një bisedë të tillë. Ideja, përpara se të formohej në mendje, ka qenë një paradë. E thënë kështu, nënkuptojmë që janë copëza idesh të shpërndara në memorie nga eksperiencia të ndryshme që janë përjetuar. Dhe, nëse vijmë sërish te shprehja e mendimit me nisjen e komunikimit, aty është verbalizimi i idesë që kaloi në disa faza brenda

4 Mel e. Schanake. Merrill, *Human Relation*, Publishing Company, 1990, f. 89.

5 Ribtickling Literature: *Educational Implications for Joke and Riddle Books in the Elementary Classroom*, Article 3, 1993, f. 3.

mendjes. Nga ana tjetër, personi që është përballë (marrësi), ka bërë të njëjtën gjë. Në ato pak momente bisede dy personat që po komunikojnë, shpërndajnë informacion sipas përjetimeve të mëparshme personale, duke shpërndarë energji për të mbrojtur idenë e krijuar si proces dhe përthithje të paraideve të reja për t'i memorizuar, që të përdoren për ide në të ardhmen, në procese të tjera të komunikimit.

## Gabimet në komunikim

Nga dëshira dhe dashuria e madhe, prindi përpiqet t'ia plotësojë fëmijës të gjitha kërkesat me mundësitë që ka. Të rritur dikur me shumë mangësi prej sistemit të kaluar, ata nuk do donin ta shihnin këtë gjë të të vegjlit e tyre. Në këtë mënyrë, i japin mesazhin fëmijës, se nuk ekzistojnë limitet. Na ka qëlluar të shohim shpesh nëpër dyqane fëmijë 3-4 vjeçarë, që bërtasin dhe kapen fort pas këmbës së nënës apo babait. Ata nuk ndryshojnë sjellje, derisa të plotësohet dëshira e momentit. Duke qarë, mund të kërkojnë ushqime të dëmshme për organizmin e tyre, mund të duan mjete të teknologjisë më të fundit dhe çfarëdo tjetër që shohin. Por të vegjlit i kanë kërkesat të shpeshta. Nëse prindi mposhtet nga këto situata, duke mos i komunikuar alternativë zgjedhjeje, do të krijojnë fëmijë që nuk njohin kufij dhe nuk e pranojnë mohimin. Pa disiplinë në komunikim, fëmijët jo vetëm do të përdorin fjalë të papërshtatshme, por edhe mund t'i bëjnë ato pjesë të fjalorit të tyre, apo të fyejnë vazhdimisht të tjerët. Në këtë mënyrë, rriten individë devijantë që nuk kanë respekt për tjetrin. Po ashtu, ka raste ku të voglit i mësohet me ngulm të jetë i fortë dhe të mos qajë, por brenda vetes fëmija ndrydhet dhe frustrohet. Nga dashuria dhe egoizmi, mund të lihet që fëmija të mbetet përherë fëmijë, ose të rritet para kohe.

## Metoda dhe instrumente për të nxitur komunikimin

### Pse-të si kërkesë për komunikim

Sipas Jean Piazhe, studiuesit të zhvillimit të fëmijës, çdo moshë ka stadin e vet (sensomotor, paraoperacional, veprimet konkrete dhe ato formale). Përgjithësisht, pas moshës 2 vjeç, fëmijët nisin të bëjnë shumë pyetje të cilat nisin me "Pse?". Ky është një proces shumë i domosdoshëm, pasi me anë të kuriozitetit ata nisin të kuptojnë si funksionojnë gjërat rreth

e rrotull. Ka raste që prindërit mund të ndihen të bezdisur dhe të lodhur, duke iu përgjigjur çdo pyetjeje, që janë me qindra në një ditë. Këto pyetje do të kulmojnë nga mosha 4-5 vjeç. Prindërit duhet t'i marrin shumë seriozisht pyetjet dhe përgjigjet që do të japin, sepse fëmijët i marrin të mirëqena dhe ato ndikojnë në formimin e tyre. Patjetër që ka edhe pyetje të sikletshme ose që kërkojnë më shumë kohë për t'u përgjigjur. Nuk është turp nëse prindi i thotë fëmijës që nuk e di, duke kërkuar së bashku në libra, ose duke pyetur dikë që është profesionist. Ndonjëherë pyetja “pse” që përdoret nga fëmija është për të tërhequr vëmendjen dhe që të jetë ai në qendër të vëmendjes, sidomos kur prindërit janë duke komunikuar me njëri-tjetrin ose me dikë tjetër. Në mendjen e tij fëmija do të bëjë një pyetje më të ndërlikuar, por aftësia gjuhësore nuk ia lehtëson këtë gjë për momentin. Ndaj prindi e drejton diskutimin duke i bërë, po ashtu, pyetje fëmijës. Për shembull: “Po ti si mendon për këtë gjë?”

Po ashtu, do të ishte e këshillueshme të zëvendësohen përgjigjet me fjalë, me anë të librave me figura. Çdo pyetje kërkon shpjegimin e duhur, pasi ky është proces shumë i rëndësishëm për mendjen e fëmijës. Ka pyetje të cilat fëmija i përsërit, edhe pse prindi mund t'ia ketë shpjeguar një herë. Ndaj, në këtë rast, mund të kërkohet përgjigjja e të voglit, duke e nxitur atë, në vend që të përgjigjet vetë prindi.

## Niveli i zërit në komunikim

Mjeti i parë i komunikimit është zëri juaj. Sa herë që i drejtoheni një audience, zëri juaj vepron si partner në përpjekjen për të komunikuar me dëgjuesit tuaj. Kur flisni, zëri është lidhja kryesore midis jush dhe dëgjuesve tuaj.<sup>6</sup>

Niveli i parë - Zëri blu, zëri i brendshëm ku njeriu nuk flet, por mendon me veten e tij. Të rriturit kanë mundësi ta përpunojnë mirë mendimin, përpara se ta shprehin, ndryshe nga fëmijët që flasin dhe tregojnë çdo gjë që u shkon ndërmend.

Niveli i dytë - Zëri jeshil, bëhet fjalë për pëshpërimën. Këtu hyn biseda private ku përdoret një zë i ulët dhe i qetë midis dy personave fizikisht afër njëri-tjetrit. Në të tilla biseda, fëmija ndihet mirë dhe i sigurt. Zakonisht mund të përdoret pas një shpërthimi (tantrum), shoqëruar me një përqafim.

Niveli i tretë - Zëri verdhë, kemi të bëjmë me një komunikim me një nivel zëri standard, brenda një hapësire të caktuar. Ky lloj zëri përdoret për biseda mes anëtarëve të familjes, miqve etj. Niveli i tretë i zërit preferohet të përdoret edhe gjatë mësimin në kopshte apo shkolla nga mësuesja.

Niveli i katërt - Zëri portokalli ka një tonalitet më të lartë, i cili përdoret në ambiente jashtë, për të thirrur dike, me arsyen se ndotja akustike është po ashtu e lartë. Nëse ky zë përdoret në komunikimin e brendshëm nga prindi te fëmija, kjo do ta acaronte shumë situatën. Fëmija jo vetëm që nuk do të qetësohej, por do të frikësohej ose do të bëhej agresiv. Që prindërit t'i kthehen zërit jeshil, duhet të parandalojnë që situata të mos rëndohet, duke mos e detyruar fëmijën të bëjë një veprim të detyruar, por duke i dhënë të paktën dy alternativa zgjedhjeje.

Niveli i pestë - Zëri i kuq, nga vetë simbolika që përfaqëson, kjo ngjyrë ngre alarmin në formën e komunikimit. Niveli i pestë i zërit nuk është gjë tjetër, veçse e bërtitura. Nëse prindërit duan të vendosin autoritetet përmes kësaj metode, jo vetëm që kanë zgjedhur metodën më të gabuar, por, nga ana tjetër, kanë bullizuar fëmijën e tyre. Bullizmi nuk është vetëm ngacmimi që ushtron një person ndaj tjetrit në shkollë apo klasë. Prindi është i pari i cili mund të dhunojë fëmijën e tij në këtë mënyrë. Rrjedhimisht, fëmija e merr të mirëqenë se personi më i rritur, i cili i bërtet, ka të drejtë ta bëjë këtë gjë, duke u bindur pa vendosur arsye në mes. Madje, këtë formë komunikimi do e brendësojë për ta shfaqur me të tjerët, kur të rritet.

## Përralla dhe tregimi si metodë për nxitjen e komunikimit

Përrallat dhe tregimet kanë shumë rëndësi në edukimin e fëmijëve, sidomos për aspektin e zhvillimit gjuhësor. Përrallat dhe tregimet janë prezantimi i parë i fëmijës me personazhe të shumtë, me hapësira më të mëdha nga ato reale. Tregimet dhe përrallat duhet të jenë bashkëshoqëruese, që kur fëmija vjen në jetë e më pas në procesin e rritjes së tij. Që kur fëmija është ende foshnje, prindi komunikon me anë të të treguarit të përrallave, duke vënë në lëvizje edhe duart. Duke lëvizur gishtat, duke i ulur dhe ngritur, sipas asaj që po rrëfëhet, kapen herë pas here edhe duart e fëmijës. Pak më vonë, mund t'i prezantohet libri që ka vetëm figura të mëdha, të qarta, me ilustrime të theksuara. Prindi nevojitet ta shoqërojë me zë, duke ia shpjeguar, apo qoftë duke përmendur ndonjë fjalë për secilën figurë. Ndërfutja e leximit në aktivitetet e ditës së fëmijës, do bëjë që ai ta kërkojë vetë këtë, si domosdoshmëri.

Faktikisht, një pjesë e përrallave kanë kuptime më të gjera dhe më të thella që fëmijët e moshës deri parashkollore nuk mund t'i kuptojnë.<sup>7</sup> Ndaj prindërit duhet të jenë të kujdesshëm në përzgjedhjen e tyre sipas moshës, duke iu shpjeguar atyre edhe fjalët e reja. Përrallat nuk janë thjesht fjali që nisin e përfundojnë. Përralla në vetvete është komunikim. Aty ka personazhe që flasin së bashku dhe japin mesazhe. Po ashtu, në përralla përdoren intonacione të ndryshme të zërit dhe fëmija kupton improvizimin. Përrallat dhe tregimet kanë funksion më të mirë nëse fëmijëve, pasi e dëgjojnë, iu thuhet ta tregojnë me fjalët e tyre. Kjo nxitje nga ana e prindërve, është shumë e nevojshme pasi shton fjalorin, përmirëson komunikimin dhe ndihmon në memorie. Aftësia e kujtesës është e rëndësishme në jetë, pasi ajo iu mundëson planifikimin apo të vendosin objektiva. Po ashtu, vënia në skenim të përrallave të treguara më parë ndihmon në zhvillimin motorik të fëmijëve.

Përmes krijimit të përrallave nga ana e prindërve, mund t'i japim mesazh fëmijëve në mënyrë indirekte dhe më të pëlqyeshme për ta. Nëse fëmija juaj ka formësuar një zakon që e bën vazhdimisht, këshillohet të krijohen përralla me personazhe të trilluara, të cilët kishin të njëjtin zakon dhe më pas arritën ta heqin. Nëse prindi do të përpiket që për të njëjtin gabim apo zakon negativ, të komunikojë përmes urdhrit, shanset që fëmija ta zbatojë janë shumë të pakta. Nëse fëmija e merr mesazhin në formë simboli, e percepton më mirë dhe mund të arrijë të zbusë pak e nga pak veset e tij.

## Komunikim me anë të lodrave dhe lojërave

Jeta e njeriut është ndërtuar në një mënyrë të tillë, ku çdo stad ka nevojë të përmbushë disa detyra kryesore. Por të mos harrojmë që edhe zhvillimi i fëmijëve është i ndryshëm, pavarësisht se ka një moshë të përafërt ku të gjithë duhet të kryejnë disa veprime të caktuara. Në fëmijëri ekzistojnë detyra, të cilat lidhen me të folurit, të ecurit, vetëshërbimet etj. Po qe se për ndonjë motiv individit nuk arrin t'i realizojë këto detyra, i gjithë mekanizmi kompleks i evolucionit të personalitetit dhe zhvillimit të tij vihet në dyshim dhe fillon e kompromentohet.<sup>8</sup> Për të ndihmuar në zhvillimin e fëmijës janë edhe lodrat dhe lojërat.

E mira do të ishte që orientimi i zgjedhjes së lodrave të mos niste nga

7 Dijana Vučković, *A Fairy tale (r)evolution: the value and the critical reading of fairy tales in the contemporary educational context*, Edizioni Università di Macerata, Italy, 2018, f. 314.

8 Ndue Kaza, *Adoleshenca stina e shpërthimeve*, Mirgeeralb, Tiranë 2006, f. 15.

gjinia, por nga lodrat kreative dhe nxitëse që formësojnë inteligjencën dhe argëtimin e fëmijës. Formueset, minilaboratorët, instrumentet muzikore, tabelat e vizatimit dhe krijimit, do të ishin një zgjedhje e mirë, e cila fiton gjithmonë mbi automatikët, shpatat, pistoletat e të tilla si këto. Me idenë për t'i mbajtur të angazhuar, prindërit prirën të blejnë pothuaj çdo muaj apo dhe më shpesh, nga një lodër të re. Një pjesë tjetër e prindërve mund t'i vendosin fëmijës disa lodra rreth e qark dhe vazhdojnë me punët e tyre. Kjo është e gabuar, pasi nuk do arrihet zhvillimi i fëmijës. Prindi mund t'i japë zë lodrave duke aktruar në forma të ndryshme. Kjo do t'i nxisë më shumë imagjinatën e fëmijëve. Imagjinata dallohet nga të menduarit realist, për faktin që është më e lirë në kombinimin e lidhjeve, varet më pak nga qëndrueshmëria e ligjeve dhe e parimeve dhe më tepër është nën ndikimin e nevojave dhe të dëshirave personale të individëve.<sup>9</sup> Për ta nxitur sa më shumë këtë aspekt, me rëndësi është që çdo veprim që bëhet në lojë të shoqërohet me shpjegim. E folura që në foshnjëri e më tej i bën veç mirë fëmijës. Madje mund të themi se më e këshillueshme është loja sesa lodra. Duke marrë kuti kartoni, pjata, lugë, gota mund të krijohet diçka me to. Nuk ka përse të bëhen blerje të reja, kur lodrat kanë nevojë thjesht të vishen me personazhe dhe të komunikojnë. Nëse fëmija ka dëgjuar, parë apo përjetuar një ngjarje, prindërit mund ta risjellin si kujtesë pozitive përmes lodrave. Lodrat bëhen ushqim për trurin, kur atyre iu shtohen funksionet që kanë përmes komunikimit.

## Komunikimi me anë të figurave

Komunikimi mund të realizohet në mënyra të ndryshme, sepse është i shumëllojshëm dhe realizohet edhe me ndihmën e mjeteve të ndryshme. Pavarësisht se për njeriun është më i theksuar komunikimi me fjalë, ai plotësohet shumë mirë edhe me anë të gjesteve apo simboleve. Një mënyrë shumë e mirë për të nxitur fëmijët për të komunikuar është edhe vizatimi ose/dhe craft-et. Fëmija mund të udhëzohet nga prindi të hedhë skicat e para që në moshën 1- vjeçare. Pavarësisht se lapsi nuk mbahen në mënyrën e duhur dhe skicat i ngjajnë shkarravinave, këto vizatime e ndihmojnë fëmijën të shprehet. Në vijim të zhvillimit të fëmijës, pas moshës 3- vjeçare, fëmijët mund të tregojnë emocione dhe ngjarje përmes vizatimeve të tyre. Një prind i kujdesshëm mund të kuptojë mesazhe përmes këtyre skicave dhe për të cilat nëse ka dyshime mund të konsultohet edhe me një

9 Prof. Dr. Mujo Hasković, *Psikologji*, Sarajevë / Prishtinë, 2006, f. 106.

psikolog. Sipas të menduarit logjik dhe zgjidhjes së problemeve, ky proces qëndron në standardin 19, ku fëmija përdor artin për të shprehur atë çfarë di, mendon, beson dhe ndjen.<sup>10</sup>

## Përfundim

Si përfundim, theksojmë rëndësinë e komunikimit që përdor prindi ndaj fëmijës, jo vetëm si përcjellës informacioni dhe domosdoshmëri për ta aftësuar në mënyrë të pavarur, por edhe për ta formësuar të voglin me cilësi më të mira kryesisht në ato ndërpersonale. Nëse aftësia e inteligjencës (IQ) është paracaktuar në mënyrë gjenetike dhe nuk mund të ndryshojë me përvojën e jetës dhe se fati ynë në të shumtën e rasteve është i caktuar me këtë lloj dhurate, ajo që mund të përpunojnë prindërit është inteligjenca emocionale.<sup>11</sup> Kjo inteligjencë ndërtohet hap pas hapi me metoda efektive të cilat janë aty pranë, që nga përrallat e thjeshta, deri te lodrat dhe lojërat që mund të krijohen nga prindi. Baza e kësaj inteligjence është empatia, apo aftësia për të kuptuar se çfarë ndjen tjetri. Fëmijët, kur janë të vegjël, përgjithësisht nuk janë përzgjedhës të tjetrit në bazë të ngjyrës së lëkurës, veshjes apo bukurisë fizike. Për ta, njeri i mirë është ai që iu qëndron pranë, duke buzëqeshur dhe duke iu falur dashuri. Me kalimin e kohës, vogëlushëve, dashje pa dashje, me qëllimin për t'i mbrojtur, prindi mund t'i krijojë në mendjen e tyre me qindra filtra frenues. Brenda këtij edukimi, empatia zvogëlohet, pasi rëndësia i shkon vetëmbrojtjes. Megjithatë, nuk duhen anashkaluar ndjenjat, si ndihmesa e tjetrit, dhembshuria, përkrahja dhe bashkëpunimi. Sipas Aristotelit problemi nuk qëndron tek emocionet, por në rregullsinë e emocioneve dhe në shfaqjen e tyre. Diku pas moshës 3 vjeç, kur i vogli krijon konceptin e vetes, prindi mund t'i prezantojë "tjetrin" si dikush që është i ndryshëm, por edhe i nevojshëm. I ndryshëm, sepse ai apo ajo mund të pëlqejë gjëra të cilat i vogli juaj mund t'i urrejë dhe anasjellas. I nevojshëm, sepse me tjetrin ndajmë hapësira, lojëra, punë dhe veprime të përditshme. Fëmijët duhet të kuptojnë se të jesh i ndryshëm në paraqitje nuk të bën më pak të bukur dhe më pak të pëlqyeshëm, përkundrazi, të bën të veçantë. Ajo që na bën njerëzorë, është komunikimi, bashkëpunimi, dhënia e ndihmës, afrimiteti etj. *Fëmijëve që iu është kultivuar empatia, përballojnë më mirë dhe më shpejt situatat problematike.* E gjitha kjo nis me përdorimin e një gjuhe të përzgjedhur, me një nivel zëri të qetë, të ngrohtë, që i jep siguri

10 *Standardet e zhvillimit dhe të nxënies të fëmijëve 3-6 vjeç*, 2016, UNICEF, f. 19.

11 Daniel Goleman, *Inteligjenca emocionale*, Bantam Books, 1995, f. 8.

fëmijës, i nxit vetërespektin, duke i mësuar kontroll të emocioneve të veta drejt një jete sociale, e cila është e komplikuar, por mund të jetë më e lehtë me këto aftësi të fituara.

## Bibliografia

1. Bauman, Zygmunt: *Moderniteti i lëngët*, Shtëpia botuese “Pika pa sipërfaqe”, 2000.
2. Dragoti, Edmond: *Psikologjia sociale*, Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2004.
3. Eco, Umberto: *Në kërkim të gjuhës së përkryer në kulturën europiane*, Shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2008.
4. Gardner, Hauard: *Dimensionet e mendjes*, Përkthim ISP, Tiranë, 2003.
5. Goleman, Daniel: *Inteligjenca emocionale*, Bantam Books, 1995.
6. Haskoviç, Mujo: *Psikologji*, Sarajevë / Prishtinë, 2006.
7. Hoxha, Mithat: *Psikologjia zhvillimore*, Shkodër, 2002.
8. J. Stephens, R. Mçallum, *Retelling Stories, Framing Culture: Traditional Story and Metanarratives in Children’s Literature*, New York, London, Garland Publishing Inc., 1998.
9. Kaza, Ndue: *Adoleshenca stina e shpërthimeve*, Shtëpia botuese “Mirgeeralb”, Tiranë, 2006.
10. Merrill, Mel E. Schanake: *Human Relation*, Publishing Company, 1990.
11. Meunier, Jean Pierre; Peraya, Daniel: *Hyrje në teoritë e komunikimit*, QSSHE, Botimi i dytë, Tiranë 2009.
12. Pettijohn, Terry: *Psikologjia*, Shtëpia botuese “Lilo”, Tiranë, 1996.
13. Ribtickling Literature: *Educational Implications for Joke and Riddle Books in the Elementary Classroom*, Article 3, 1993.
14. Tarelli, Marsela: *Fëmijët investim i së ardhmes*, Shtëpia botuese “Alsar”, Tiranë, 2014.
15. Toastmasters International, *Tips for Adding Strength and Authority to Your Voice*, 2011.
16. UNICEF: *Standardet e zhvillimit dhe të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç*, 2016.
17. Vasta, Ross; M. Haith, Marshal; A. Miller, Scott: *Psikologjia e fëmijës*, Shtëpia botuese “Uegen” Tiranë, 2008.
18. Vučković, Dijana: *A Fairy tale (r)evolution: the value and the critical reading of fairy tales in the contemporary educational context*, Edizioni Università di Macerata, Italy, 2018.